



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.6/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në konfliktin administrativ të paditësit “A...” ShPK me Seli në Gjilan, Rr. “....” pa nr. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.A nga Gjilani, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 12,079.40 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me datë 13.09.2022, në prani të përfaqësuesit të paditësit, H.A, dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “A...” ShPK me Seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.A.
- II. ANULOHET Pjesërisht vendimi nr. 343/2019 i datës 20.09.2019, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe periudha tatimore 06/2016 për llojin e tatimit TVSH-ë, referuar transaksionit në shumën prej 67,107.75 euro, dhe lënda lidhur me këtë çështje kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE, tek e paditura.
- III. Rivlerësimet tjera tatimore mbesin në fuqi sipas raportit të kontrollit të datës 11.07.2019, njoftim vlerësimeve nga e paditura si dhe ndëshkimet e aplikuara e të vërtetuara me vendimin nr. 343/2019 i datës 20.09.2019.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 03.10.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurit Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit nr.343/2019 i datës 20.09.2019. Përfaqësuesi i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi se Kontesti në këtë lëndë rrjedh nga Raporti i Kontrollit që i referohet periudhës Qershor 2016. Këtu sipas nesh është bërë një gabim

teknik nga ana jonë, me ç ‘rast është bërë evidentimi i deklarimit të TVSH-së, ku është rritur shuma prej 67,107.75 €, e që kjo shumë meqë nuk është realizim është dashur të evidentohet në rubrika të tjera të deklaratës përkatëse për TVSH. Tutje, e njoftoj gjykatën se edhe përkundër se kjo çështje, pra ky gabim gojarisht i është komunikuar Inspektorit gjatë kontrollit, i njëjti kur e ka sjellë raportin e kontrollit, nuk e ka marrë parasysh këtë, pra nuk e ka evituar këtë problem. Neve kemi bërë edhe ankesë në Departamentin e Ankesave në ATK, mirëpo Inspektori i ATK-së nuk ka qenë prezent në atë seancë, andaj edhe Departamenti i Ankesave vetëm e ka vërtetuar gjendjen e Inspektorit pa marrë për bazë pretendimet tona dhe lëshimet e Inspektorit që i referohen periudhës 06.2016 për TVSH. E njoftojmë gjykatën se transaksioni prej 67,107.75 €, është i shkaktuar nga Depo e Prodhimit të këtu paditësit, dhe i njëjti material-prodhim i gatshëm ka shkuar në objektin investues, si dëshmi që malli është shkaktuar nga Depo e Prodhimit të këtu paditësit është Fletë dërgesa e prodhimit të gatshëm nr. ... e datës 18.06.2016, si dhe Fletëpranimi i prodhimit të gatshëm nr. ... i datës 18.06.2016, dëshmi këto të cilat ia paraqesë gjykatës në këtë seancë. Po ashtu, këtë fakt e vërteton edhe Kartela 121, nga ku është zbritur shuma prej 67,107.75 €, e cila shumë tani sipas kartelës së kontos 191, është ngarkuar tek objekti investues. E njoftojmë gjykatën se të gjitha elementet e tjera janë të pranueshme ashtu siç i ka konstatuar e paditura ATK në raport të kontrollit, përfshirë edhe ndëshkimet dhe të gjitha obligimet i kemi paguar. Andaj, kërkoj nga gjykata që të aprovohet padia si e bazuar, të anulohet vendimi kontestues 343/19 i datës 20.09.2019, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim-rivendosje tek e paditura ATK, ashtu që e njëjta në ri procedurë të vlerësojë edhe njëherë periudhën tatimore 06.2016 për TVSH mbi bazën e provave të paraqitura edhe në këtë seancë, si dhe të ftojë edhe Inspektorin Tatimor i cili e ka përgatitur Raportin e Kontrollit të datës 11.07.2019, me qëllim që nga i njëjti të marrë konstatimin për lëshimin e tij eventual në rastin e përgatitjes së atij raporti të Kontrollit. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 06.11.2020, ka deklaruar se tatimpaguesi i pakënaqur me vendimin kontestues, ka parashtruar ankesë në gjykatë me të cilën e kërkon anulimin e vendimit dhe kërkon që në seancë të jetë prezent edhe inspektori i kontrollit. Tutje deklaroi se paditësi konstaton se gjatë kontrollit është lëshuar një gabim teknik i cili është identifikuar pas dorëzimit të raportit final nga inspektori, ky gabim është rezultat i një transaksioni intern i cili nuk është regjistruar në libër të shitjes mirëpo është deklaruar në TVSH në periudhën 06/2016 dhe vlera prej 67,107.75€, nuk është e hyrë siç vlerëson DA-ja. Lidhur me këtë Divizioni i Ankesave konstaton se vlerësimi nga ATK-ja është bazuar në dispozitat e legjislacionit tatimor gjegjësisht neni 19 paragrafi 2

të ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. ATK-ja pas analizimit të shkresave materiale të lëndës ka vërtetuar se vet paditësi ka deklaruar të hyra të tatueshme në vlerë prej 135,326.90€ bazë për llogaritje të obligimit të TVSH-së për periudhën 06/2016, dhe lidhur me këtë pikë kontestuese nuk ka pasur ankesë nga paditësi në draft raportin e dorëzuar nga kontrolli. Në raportin e kontrollit nuk potencohet askund ky transaksion nga ana e kontrollit së blerjet e njësisë së prodhimit janë zbrit, apo për të konstatuar se është bërë një gabim gjatë procedurës së kontrollit dhe nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet nëse paditësi ka shkarkuar depon e prodhimit për këtë transaksion. ATK-ja mbi bazën e fakteve të paraqitura më lartë i propozon gjykatës që pas shqyrtimit të provave të marr aktgjykim me të cilin refuzohet padia e ushtruar nga “A...” ShPK si e pabazuar dhe të aprovohet Vendimi i Departamentit të Ankesave të ATK-së nr. ... i datës 20.09.2019 si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor dispozitave të nenit 41 të LKA-në mungesë të palës së paditur ngase e njëjta e ka pranuar ftesën për seancë në mënyrë të rregullt, ndërsa me parashtresës së datës 08.09.2022 e ka njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që të vepohet konform nenit 38 paragrafi të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 13.09.2022 ka administruar provat dhe atë: vendimi Kartelat e Kontos 121 për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2016, 191 për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2016, Libri i Shitjeve për vitin 2016, Formularët e Deklarimit të TVSH-së për vitin 2016, Libri i Blerjeve për vitin 2016, Vendimi ... i datës 20.09.2019, Ankesa e ushtruar në ATK e datës 23.07.2019, Përgjigja në padi e datës 06.11.2020, Gjendja e Borxheve e datës së printimit 11.05.2020, Raporti i Kontrollit i datës 11.07.2019, Fletë dërgesa nr.8/2016 e datës 18.06.2016, dhe Fletëpranimi nr. ... i datës 18.06.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, raporti i kontrollit dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi ka pranuar raportin e kontrollit të datës 11.07.2019, nga e paditura, me ç ‘rast nga gjetjet e të njëjtit është konstatuar qarkullim dhe tatim shtesë si dhe janë aplikuar ndryshime në TVSH për periudhën e kontrollit. Jo kontestuese mbasin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave sa i përket periudhës 06/2016 e cila ka të bëjë me llogaritjen e TVSH-së, ku është rritur shuma në vlerë prej 67,107.75€ si rezultat i transaksionit të shkartuar nga depo e prodhimit të paditësit, ku i njëjti material në vlerën prej 67,107.75€ , ka shkuar në objektin investues. Për këtë ankesë, ATK-ja me datë 20.09.2019, ka sjell vendimin nr. 343/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, e ndaj të cilit paditësi me padinë e datës 03.10.2019, ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Gjykata nga vendimi kontestues vëren se ai përmban pjesërisht të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit në pikën e kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare lidhur me transaksionin në vlerën prej 67,107.75€, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative në shqyrtim, dhe një arsyetim i tillë për Gjykatën në këtë pikë kontestuese është i mangët, i pa qartë dhe kontradiktor. Andaj vendimi si i tillë edhe nuk mund të ekzaminohet në çështjen kontestuese, e sidomos nëse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike, si dhe kur provat nuk janë të arsyetuara veç e veç dhe të ndërlidhura së bashku, andaj doemos edhe është dashur të anulohet lidhur me periudhën tatimore 06/2016 për llojin e tatimit TVSH-ë.

Gjykata konstaton se e paditura në arsyetim të vendimit kontestues ka përshkruar vetëm faktin se vet tatimpaguesi i ka deklaruar të hyrat e tatueshme në vlerë prej 135,326.90€, bazë për deklarimin e TVSH-së për periudhën 06/2016, nuk ka pasur ankesë të shkruar nga paditësi në draft Raportin e kontrollit dhe në Raport të kontrollit nuk potencohet askund se blerjet e njësisë së prodhimit janë zbritje, apo për të konstatuar se është bërë gabim, dhe nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet nëse tatimpaguesi ka shkarkuar depon e prodhimit për këtë transaksion. E paditura një konstatim të tillë do të duhej ta bazonte në prova dhe dëshmi konkrete dhe jo vetëm t’i mjaftonte ky konstatim abstrakt bazuar vetëm në përshkrimin e gjendjes dhe se arsyetimi i tillë i pa-qartë dhe kontradiktor

është i barasvlershëm me mungesë të arsytimit e që paraqet shkelje në dëm të këtu paditësit e pa evitimin e të cilës nuk mund të procedohet tutje.

Gjykata nga administrimi provave në këtë lëndë të konfliktit administrativ, ka gjetur se e paditura në raportin e kontrollit të datës 11.07.2019, e i cili është vërtetuar me vendimin kontestues nga departamenti i ankesave pranë ATK-së, në faqen 12 në pikën 5.1.29 është konstatuar se tatimpaguesi-këtu paditësi në shumicën e rasteve të verifikuara vërehet se ka respektuar dispozitat e nenit 52 të Ligjit mbi TVSH-në lidhur me ngarkesën e kundërt, përveç në dy raste të cekura në raportin e kontrollit, mirëpo gjykata ka gjetur se këto raste nuk kanë të bëjnë me vlerën e transaksionit prej 67,107.75€. Nga ana tjetër paditësi ka dorëzuar dëshmi para gjykatës me të cilën vërtetohet fakti se malli në vlerë prej 67.107,75€ është shkarkuar nga depo e prodhimit me datë 18.06.2016 përmes flete dërgesës së prodhimit të gatshëm nr.08/16 e datës 18.06.2016 dhe është dorëzuar në objektin pranues përmes fletëpranimit të prodhimit të gatshëm nr. Gjykata ka verifikuar edhe librin e shitjeve të paditësit për periudhën 01.06.2016 deri më 30.06.2016 dhe ka konstatuar se paditësi nuk ka realizuar shitje në vlerë prej 67,107.75€. Prandaj këto dokumentacione për Gjykatën japin të dhëna se nuk mund të shqyrtohet ky konflikt administrative për periudhën tatimore 06/2016, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative nga e paditura, për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht e për ato të vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, andaj edhe doemos duhen anuluar akti kontestues dhe lënda të kthehet në rishqyrtim – rivendosje pranë të paditurës për eliminimin e të metave si më lartë.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj Gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet si më lartë dhe ta trajtoj dhe vlerësoj edhe njëherë periudhën tatimore 06/2016 lidhur me tatimin TVSH-ë, sipas ankesës së datës 23.07.2019 të ushtruar nga këtu paditësi në ATK-ë për periudhën kontestuese, e të cilat nuk janë aprovuar me vendimin kontestues, të analizoj dhe të deklarohet lidhur me Kartelat e Kontos nr. ..., për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2016, pozicioni i datës 18.06.2016, dhe nr. ... për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2016, pozicioni i datës 18.06.2016, pastaj të marr për bazë Librin e Shitjeve për vitin 2016, së bashku më Fletë dërgesën nr. ... të datës 18.06.2016, dhe Fletëpranimin nr. ... të datës 18.06.2016, dhe vetëm pas kësaj dhe mbi bazën e të gjeturave si dhe sqarimeve si në seancën gjyqësore të datës 13.09.2022 të sjell vendim të drejtë dhe të bazuar në legjislacionin tatimor të aplikueshëm.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon pjesërisht vendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura për periudhën tatimore 06/2016 lidhur me TVSH-në. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedure të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.6/2022 datë 13.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar GASHI

G j y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.